



P11. Kultura dhe shërbimet reakreacionale

"Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturoro- artistike, aseteve të trashigimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë në sektorët arkeologjik, etnografik, historik, te fotografise, muzikës, teatrit etj. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës. Zbulimi dhe mbështetja e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive"

Përmbajtja

P11. Kultura dhe shërbimet reakrecionale	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	3
3. Funksionet:	4
3.1 F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	4
3.2 F2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	5
3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2	6
3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2.	7
3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.	8
3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O2.	9
4. Buxheti i programit të Kultura dhe shërbimet reakrecionale.	9
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Kultura dhe shërbimet reakrecionale	11

P11. Kultura dhe shërbimet rekreacionale

1. Hyrje

Shkodra, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore do të bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor.

Kjo trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me shtrirje nga Alpet deri në bregdet, do të bëhet faktor kyç për rritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve.

Njëqind e katërdhjetë e dy monumente kulture janë sot të përfshira në hartën e re administrative territoriale të Bashkisë së Shkodrës. Programi ynë synon fuqizimin e strukturës administrative dhe mirëorganizimin e institucioneve aktuale të kulturës së Bashkisë.

Një nga kolonat kryesore të programit do të jetë rivitalizimi i institucioneve aktuale të kulturës. Shkodra ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në art dhe kulturë, me të cilat ajo merr kuptim. Këto vlera kanë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Pjesë e programit do të jetë mbështetësja dhe nxitësja e zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet institucioneve dhe enteve lokale.

2. Politikat e zhvillimit

Pikënisja e programit tonë është mirë menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore-artistike, aseteve të trashëgimisë kulturore, duke risjellur në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorit arkeologjik, etnografik, historik, te fotografise, muzikës, teatrit etj.

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës.

Muzika folklorike dhe qytetare shkodrane, promovimi dhe organizimi i festivaleve të përvitshme dhe aktivitetet kulturore do të pasurojnë traditën muzikore të qytetit me kompozime dhe shfaqje të reja duke gjallëruar jetën artistike në Shkodër.

Synojmë promovimin e formave alternative të administrimit dhe marketingut të Arteve pamore dhe institucioneve të tjera kulturore në Shkodër pjesë e rrjetit muzeve dhe institucioneve kulturore për t'u vizituar.

Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përçimi i vlerave kulturore dhe sportive do të jete nje nga politikat e programit.

Bashkia e Shkodrës do të mbështesë dhe kontribuojë në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij me synimin e ndërthurjes së politikave vendore dhe strategjive ndërkombëtare për bibliotekat publike

3. Funksionet:

3.1 F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F1.O1: Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mireadministrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Institucionet e trashëgimisë kulturore prane Bashkisë së Shkodrës janë Muzeu Historik dhe Galeria e Arteve. Janë të nevojshme zhvillimi i aktiviteteve promovuese të vlerave të tyre, si nepermjet siteve web dhe takimeve publike.
- Vlerësohet e nevojshme organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese të trashëgimisë kulturore me komunitetin
- Informimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore në komunitet nepermjet takimeve publike dhe zhvillimit të seminareve me artiste të rinj.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Synojme të zhvillojme 9 aktivitete të trashëgimisë kulturore.	Synojme të zhvillojme 10 aktivitete të trashëgimisë kulturore	Synojme të zhvillojme 11 aktivitete të trashëgimisë kulturore.
Informimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore në komunitet nepermjet takimeve publike dhe zhvillimit të seminareve me artiste të rinj.	Informim dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore në komunitet nepermjet takimeve publike dhe zhvillimit të seminareve me artiste të rinj.	Informim dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore në komunitet nepermjet takimeve publike dhe zhvillimit të seminareve me artiste të rinj.
	Vazhdim i digjitalizimit të pasurive të trashëgimisë kulturore	Vazhdim i digjitalizimit të pasurive të trashëgimisë kulturore
Permiresimi i kushteve të ruajtjes dhe konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore prane Muzeut dhe Galerisë së Arteve .	Vijim i permiresimit i kushteve të ruajtjes dhe konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore prane Muzeut dhe Galerisë së Arteve.	Vazhdim i digjitalizimit të pasurive të trashëgimisë kulturore.
Permiresimi i sistemit të ekspozimit dhe ndricimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.		
Permiresimi i kushteve të ruajtjes së fondeve.		

3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P11.F1.O1 .A1 "Java e Pavaresisë" Ekspozitë etnografike me elemente kostumografie dhe zejesh	30
P11.F1.O1.A2 Prodhim dhe Shtypje Biletash	150
P11.F1.O1.A3 Dita nderkombetare e monumenteve dhe siteve arkeologjike	100

P11.F1.O1.A4 Mbeshtetje per funksionimin e aktivitetit dhe sherbimin ne vazhdim te Muzeut historik Shkoder	410
P11.F1.O1.A5 Ribotim i guides te Muzeve te Bashkise Shkoder	300
P11.F1.O1.A6 Risistemim i ekspozimit te objekteve te gurta ne Muze Oso Kuka	144
P11.F1.O1.A7 Rikonstruksion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër.	1,000
P11.F1.O1.A8 Publikime promocionale, fletpalosje e guide per Vendin e Deshmise e Kujteses	150
P11.F1.O1.A9 Cikel bisedash dhe ndergjegjesim i te rinjve nen fokusin e librave me tematike mbi te kaluaren komuniste.	70
P11.F1.O1.A10 Mirembajtje ndertesases VDK	300
P11.F1.O1.A11 Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve. Ekspozita me titull "Edhe ne luanim dikur"	30
P11.F1.O1.A12 Ekspozita "Salloni i vjeshtës "	465
P11.F1.O1.A13 Çmimi "Idromeno".	350
P11.F1.O1.A.14 "Personazh i ftuar" - Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.	140
P11.F1.O1.A15 Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe workshop me artistë të rinj	150
P11.F1.O1.A16 Aktivitete në partneritet me subjekte kulturore të tretë	100

3.2 F2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F2.O1 Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve te institucioneve kulturore dhe artistike te Bashkise se Shkodres.

Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:

- Rikonstrukcioni i Teatrit "Migjeni"
- Mobilimi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" dhe Galerisë së Arteve
- Përmirësimi i mjediseve ekspozuese te Muzeut Historik dhe Muzeut të Kështjellës
- Mjediset e Teatrit "Migjeni" jane rikonstruktuar per nje zhvillim te sigurte aktivitetesh, por duhet vijuar me tej me permiresimin e metejshem te ambjenteve te tjera te sherbimit.
- Instrumentet muzikore te amortizuara dhe kane nevojë per riparim te tyre dhe pasurim me instrumente te reja.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Mjediset e Teatrit "Migjeni" jane rikonstruktuar per nje zhvillim te te sigurte aktivitetesh , por duhet vijuar me tej me permiresimin e metejshem te ambjenteve te tjera te tij si Arkiva dhe garderoba.	Mjediset e teatrit "Migjeni" jane rikonstruktuar per nje zhvillim te te sigurte aktivitetesh , por duhet vijuar me tej me permiresimin e metejshem te ambjenteve te tjera te sherbimit.	Mjediset e teatrit "Migjeni"jane rikonstruktuar per nje zhvillim te te sigurte aktivitetesh , por duhet vijuar me tej me perfundimin e riparimit te ambjenteve te tij.

3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.02

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P11.F2.01.A1 Një Piano për Qytetin e Artit	3,000
P11.F2.01.A2 Blerje impiant audio për koncerte	3,674
P11.F2.01.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore	150
P11.F2.01.A4 Prodhim dhe shtypje biletash për Teatrin "Migjeni"	73,902
P11.F2.01.A5 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"	1,711
P11.F2.01.A6 Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj.	603
P11.F2.01.A7 Shërbime administrative për Teatrin "Migjeni"	1,000
P11.F2.01.A8 Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike	665
P11.F2.01.A9 Rregullimi dhe sistemimi i arkives së Teatrit dhe garderober	

F2.02 Pasurimi dhe gjallerimi i jetes kulturore nepermjet zhvillimit te aktiviteteve artistike dhe kulturore pergjate gjithe vitit.

Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:

- Jane realizuar 11 aktivitete kulturore dhe 11 premiera te Teatrit "Migjeni"
- Muzeu Historik ka realizuar 6 ekspozita tematike dhe 5 aktivitete perkujtimore;
- Qendra "Pjeter Gaci" ka realizuar 4 aktivitete kulturore e rifillimin e Festivalit të këngës qytetare "LuleBore".

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Do te realizohen aktivitete kulturore te tradites, duke permiresuar vazhdimisht cilesine e tyre, per gjate vitit. Do te zhvillohen festa tradicionale te Shkodres	Do te realizohen aktivitete kulturore te tradites, duke permiresuar vazhdimisht cilesine e tyre, per gjate vitit. Do te zhvillohen festa tradicionale te Shkodres	Do te realizohen aktivitete kulturore te tradites, duke permiresuar vazhdimisht cilesine e tyre, per gjate vitit. Do te zhvillohen festa tradicionale te Shkodres
Do te zhvillohen aktivitete perkujtimore dhe java e festave te nentorit.	Do te zhvillohen aktivitete perkujtimore dhe java e festave te nentorit.	Do te zhvillohen aktivitete perkujtimore dhe java e festave te nentorit.
Riparimi dhe pasurimi i fondit te instrumenteve muzikore	Riparimi dhe pasurimi i fondit te instrumenteve muzikore.	Riparimi dhe pasurimi i fondit te instrumenteve muzikore.
Do te realizohen premiera te teatrit "Migjeni" sipas kalndarit vjetor.	Do te realizohen premiera te teatrit "Migjeni" sipas kalendarit vjetor.	Do te realizohen premiera te teatrit "Migjeni" sipas kalendarit vjetor.
Premierat do te perfshijne drama, komedi dhe estrade	Premierat do te perfshijne drama, komedi dhe estrade	Premierat do te perfshijne drama, komedi dhe estrade

3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P11.F2.O2.A1 "Dita e Luleve" 6 Maj	500
P11.F2.O2.A2 "Ndërmendje"	1,300
P11.F2.O2.A3 Fjala artisitke me nxenesit e shkollave te mesme ne nderim te figurave te shquara.	300
P11.F2.O2.A4 Aktivitete me rastin e "2 Prillit"	270
P11.F2.O2.A5 Festival Jazz-it	800
P11.F2.O2.A6 Karnavalet	560
P11.F2.O2.A7 Koncertet e verës	600
P11.F2.O2.A8 Aktivitetet e fundvitit	300
P11.F2.O2.A9 Festa e Muzikës	200
P11.F2.O2.A10 Aktivitete të ndryshme gjatë vitit	1,000
P11.F2.O2.A11 Mbështetje për funksionimin e këshillit artistik	200
P11.F2.O2.A12 "Lëvizja e Postribës", aktivitet përkujtimor	100
P11.F2.O2.A13 Koncert – muzike e filmit shqiptare - Orkestra Frymore e qytetit të Shkodrës	300
P11.F2.O2.A14 Çmimi "Pjetër Gaci", Edicioni 16-të	1,309
P11.F2.O2.A15 "Ahengu Shkodran"	479
P11.F2.O2.A16 Mbështetje për funksionimin e grupit të valleve	720
P11.F2.O2.A17 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë".	2,500
P11.F2.O2.A18 Orkestra frymore, honorare vjetore	3,674
P11.F2.O2.A19 "Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore"	234
P11.F2.O2.A20 "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare"	320
P11.F2.O2.A21 Festivali i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë	70
P11.F2.O2.A22 Riparimi i Hyrjes se Qendres Pjeter Gaci	140
P11.F2.O2.A23 Riparime dhe blerje instrumenta muzikore tek Qendra Kulturore Pjeter Gaci	497
P11.F2.O2.A24 "Nje zjarrfikes ne oborrin e teatrit"	1,170
P11.F2.O2.A25 "Hidrocentrali ne thatesiren e poshtme"	1,400
P11.F2.O2.A26 "Se tane puna asht te hunda"	350
P11.F2.O2.A27 "Show 2017"	800
P11.F2.O2.A28 "Zinxhiri i keqkuptimeve"	1,000
P11.F2.O2.A29 "Pranvere me kange"	650

3.3. F3. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambjenteve per lexim me qellimin e edukimit te pergjitheshem te qytetareve.

F3.O1: Promovimi dhe nxitja e leximit si instrument edukimi duke rritur aksesin dhe cilesine e sherbimit prane Bibiotekes Marin Barleti.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Janë zhvilluar shumë aktivitete të ndryshme letrare me shkrimtarë duke përfshirë të rinjtë dhe libërdashësit.
- Janë promovuar vlerat dhe traditat gjuhësore të rajonit të veriut.
- Është botuar për herë të parë periodiku “GEGNIA”.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Promovimi i vlerave të veprimtarisë patriotike shkodrane në shërbim të kultures kombëtare.	Promovimi i vlerave të veprimtarisë patriotike shkodrane në shërbim të kultures kombëtare.	Promovimi i vlerave të veprimtarisë patriotike shkodrane në shërbim të kultures kombëtare.
Do të promovohen vlerat dhe traditat gjuhësore të rajonit të veriut	Do të promovohen vlerat dhe traditat gjuhësore të rajonit të veriut	Do të promovohen vlerat dhe traditat gjuhësore të rajonit të veriut

3.3.1 Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P11.F3.O1.A2 Feste për 100 vjetor të krijimit të bibliotekës popullore të Shqipërisë.	108
P11.F3.O1.A3 Botim Periodiku “Gegnja” e përkohshme kulturore-artistike	270
P11.F3.O1.A4 Festivali letrar i Shkodrës	50

F3.O2 Ruajtja, mirë administrimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës “Marin Barleti”.**Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:**

- Është realizuar blerja e periodikut shqip dhe të huaj, fond librash për fëmijë, të rritur dhe fondi albanologjik.
- Fondi i kësaj Biblioteke është shtuar, mirëadministruar përherë duke u financuar dhe pasuruar në baze të nevojave që ajo ka për shtesë titujsh të rinj;
- Është realizuar mirefiksionimi i mjediseve për lexuesit.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Pasurimi i fondit të periodikut shqip dhe të huaj, fond librash për fëmijë, të rritur dhe fondit albanologjik.	Pasurimi i fondit të periodikut shqip dhe të huaj, fond librash për fëmijë, të rritur dhe fondit albanologjik.	Pasurimi i fondit të periodikut shqip dhe të huaj, fond librash për fëmijë, të rritur dhe fondit albanologjik.
Janë ruajtur dhe mirembajtur fondet e bibliotekës.	Janë ruajtur dhe mirembajtur fondet e bibliotekës.	Janë ruajtur dhe mirembajtur fondet e bibliotekës.
Janë përmirësuar kushtet përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura.	Janë përmirësuar kushtet përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura.	Janë përmirësuar kushtet përmes administrimit, trajtimit dhe ruajtjes së materialeve bibliotekare me synimin, që pas disa vitesh nga magazinat e librave, të kthehen pika shërbimi me fonde të hapura.
Është pasuruar dhe	Është pasuruar dhe	Është pasuruar dhe

përmirësuar informacioni online	përmirësuar informacioni online	përmirësuar informacioni online
Është përmirësuar cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.	Është përmirësuar cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.	Është përmirësuar cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.

3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.02.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P11.F3.02.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	1,100
P11.F3.02.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës	25,500


4. Buxhetimi i programit të Kultura dhe shërbimet rekreative.

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Kulturës dhe shërbimeve rekreative planifikohet buxheti me vlerë totale 87,216 mijë lekë ndër të cilat 53% për paga dhe sigurime shoqërore, 34 % shpenzime operative, 6 % transferta dhe 7 % investime.

Tabelë 1 Planifikimi për Kultura dhe shërbimet rekreative


Programi P11.	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2016	40,965	20,547	0	11,655	13,367	86,534
Plani i ndryshuar 2016	40,799	25,920		5,671	14,144	86,534
I pritshmi 2016-12-mujor	35,480	22,890		1,630	4,671	64,671
Plani 2017	46,268	29,728	0	5,260	5,960	87,216
Plani 2018	47,195	28,853	0	5,060	2,000	83,108
Plani 2019	48,139	28,853	0	5,060	2,000	84,052

P11.Kultura dhe shërbimet rekreative



Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për kulturën dhe shërbimet rekreative

Burimet e financimit per Kultura dhe sherbimet rekreacionale



Grafik 2 Burimet e financimit për financimin e programit për kulturën dhe shërbimet rekreacionale

5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Kultura dhe shërbimet rekreative

Nr.1	P11.F1.O1 .A1 “Java e Pavarësisë” Ekspozitë etnografike me elementë kostumografie dhe zejesh.	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet rekreacionale Funksioni: P11.F1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.																																			
i. Situata																																					
Muzeu Historik Shkodër çdo vit organizon aktivitete në fund të nëntorit, duke ju bashkëngjitur aktiviteteve tëorganizuara nga Bashkia Shkodër në kuadër të Javës së Pavarësisë. Vitin që shkoi u zhvillua ekspozita «Shkodra gjatë Luftës së Parë Botërore», e cila solli në vëmendje fakte dhe dokumente që vërtetojnë forcën e një shoqërie, e cila ndërtohej kur bota shkatërrohej. Ekspozita pati një impakt shumë pozitiv tek publiku dhe në veçanti tek grupet e studiuesve të historisë. Këtë vit Muzeu Historik Shkodër, vjen me një ekspozitë të veçantë vlerash të spikatura të trashëgimisë tonë kulturore. Ekspozita është me karakter etnografik, e cila përmban kostume dhe zeje. Trashëgimia materiale që ruan muzeu në rrafshin e etnografisë është e një llojshmërie të gjerë dhe shumë disiplinare.Njohja e publikut me to mbetet qëllimi kryesor i këtij aktiviteti. Përveç kësaj, një aspekt tjetër që përcjell ekspozitaështëtendenda për të korrigjuar një kostumografi të përcudnuar që sot shfaqet larg vlerave origjinale, duke rrezikuar identitetin e trashëgimisë tonë. Humbja në kohëe shumëprej zejeve të vjetra që plotësojnë panoramën e kësaj tradite, na shtyn të risjellim në vëmendje vlera shkencore tësakta në rrashfin etnografik dhe albanologjik. Llojshmëria e materialeve që do të ekspozohen, flet për diapazonin e gjerë të rajonit tëShkodrës dhe kontakteve që ka zhvilluar me botën anëmbanë. Kostumet, veçanësia e tyre sipas vendit, klimës,statusit shoqëror, pasurisë së dekoracioneve, funksionalitetit, me zejet si zanate dhe mjete që përpunojnë këto projeksione estetike, mbeten një kërshtëri e gjithë pranuar.																																					
ii. Synimi i projektit																																					
- Synimi kryesor ështënxjerrja në pah e vlerave të kostumografisë dhe zejeve; - Njohja e publikut, në veçanti e të rinjve,me vlerat e vërtetatë trashëgimisë materiale kombëtare;																																					
iii. Aktivitetet kryesore të projektit																																					
- Përzgjedhja e materialeve që do ekspozohen, pjesë kostumesh; - Përzgjedhja e mjeteve të zejtarisë; - Kurimi i fondit të objekteve në funksion të ekspozimit; - Përgatitja e materialeveforeksqë do tësuportojnëkonceptinkuratorialtëekspozimit; - Përgatitja e materialeve promocionale për aktivitetin;																																					
b) Rezultatet që prisni																																					
- Ruajtja dhe përcjellja e historisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore; - Nxitja e aplikimit të këtyre punimeve në ditët e sotme; - Rikthimi i vëmendjes së publikut tek objektet dhe krijimtaria artizanale; - Afrimi i të rinjve me traditat e vërteta të Kombit shqiptar.																																					
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshmenëprojekt																																			
- StafiiMuzeut; - Vizitorët e target grupeve të ndryshme; - Artizan profesionist dhe amator		BashkiaShkodër Donatorëtëmundshëm																																			
e) Shpenzimet e llogaritura																																					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		<table><tr><td rowspan="2">Totali (mijë lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr><tr><td>Paga</td><td>Siguri me</td><td>Operativ e</td><td>Transferi me</td><td>kapitale</td></tr><tr><td>A.1</td><td>Prerjenë material foreks12 m²x 1.6 lekëpër m²</td><td></td><td></td><td>30</td><td></td></tr><tr><td>A.2</td><td>Baner 3 copë 1m x 1m x 1 lekë</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td>Ftesa 220 copë</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td>Shuma</td><td>30</td><td></td><td>30</td><td></td></tr></table>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapitale	A.1	Prerjenë material foreks12 m²x 1.6 lekëpër m²			30		A.2	Baner 3 copë 1m x 1m x 1 lekë						Ftesa 220 copë						Shuma	30		30	
Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																																				
	Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapitale																																
A.1	Prerjenë material foreks12 m²x 1.6 lekëpër m²			30																																	
A.2	Baner 3 copë 1m x 1m x 1 lekë																																				
	Ftesa 220 copë																																				
	Shuma	30		30																																	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		<table><tr><td rowspan="2">Totali (mijë lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr><tr><td>Paga</td><td>Siguri me</td><td>Operativ e</td><td>Transferi me</td><td>kapitale</td></tr><tr><td>A.1</td><td>Shpenzime promocionale (Ftesa ,banera, etj)</td><td>30</td><td></td><td>30</td><td></td></tr><tr><td>A.2</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:					Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapitale	A.1	Shpenzime promocionale (Ftesa ,banera, etj)	30		30		A.2																	
Totali (mijë lekë)	Nga kjo:																																				
	Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapitale																																
A.1	Shpenzime promocionale (Ftesa ,banera, etj)	30		30																																	
A.2																																					

	Shuma	30			30		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operativ e	Transferi me	kapitale
A.1	Shpenzime promociionale (Ftesa ,banera, etj)	30			30		
A.2							
	Shuma	30			30		
f) Periudha e zbatimit Nëntor 2017		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Muzeut Historik					

Nr.2	P11.F1.O1.A2 Prodhim dhe Shtypje Biletash	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet reakreionale Funksioni: P11.F1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.				
i. Situata						
Muzeu ka si kërkesë të përvitshme prodhimin dhe shtypjen e biletave,që lidhet direkt me administrimin e institucionit në cilësinë e shërbimit të bileta shitjes për vizitorët që vijnë në muze. Bileta shitja, përveç funksionit matës të njërive që vizitojnë institucionet e trashigimisë, funksionon edhe si mundësi arkëtimi për fonde që mund të përkthehen nesër në mundësi zhvillimi të institucionit duke ndikuar në promovimin e tij. Prodhimi dhe shtypja e biletave në kohë,është domosdoshmëri para fillimit të sezonit turistik. Për vitin që kaloi u porositën 10 000 copë bileta seria C, sasi e cila me tepricën e vitit 2015-të mbulojë fluksin e vizitorëve në një numër rreth 16000 persona. Ky numër mblidhet nga të tre qendrat muzeale, përkatësisht; Banesa “Oso Kuka”, Muzeu i Kalasë dhe Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës. Nisur nga trendi i këtij viti,duke parë që grafiku i vizitave ka shënuar rritje, këtë vit parashikojmë prodhimin e 20 000 copë bileta seria D. Prodhimi dhe shtypja e biletave kryhet pranë Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë në Tiranë, e miratuar nga Ministria e Financave. Biletat prodhohen me të gjithë parametrat ligjor dhe informues duke patur në trupin e tyre,përveç informacionit bazë si:çmimi dhe destinacioni, edhe të dhëna mbi faqen zyrtare WEB të Muzeut Historik Shkodër.						
ii. Synimi i projektit						
• Përmeshja e detyrimitligjor, • Faktimi i shërbimit ndaj vizitorit, • Të masë trendin e arkëtimeve, • Të shtojë vizitueshmërinë në Muze, • Promovimiittrashëgimisëkulturore						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
• Konsulta me diferencën e biletave të vitit të kaluar, • Rakordimet dhe llogaritja për vitin e ardhshëm, • Përpilimi i specifikimeve teknike të biletës , e cila është një masë me vlerë e miratuar (çmimi iBiletës) me VKB, sipas ligjit për Muzetë. • Në biletë parashikohen të shënohen, të dhëna që qartësojnë numrin rendor sipas radhës së fletëbiletës, shenja dalluese , logot e secilit muze, adresa dhe faqja web zyrtare si mundësi referimi të vazhdueshëm dhe standart shërbimi.						
b) Rezultatet që prisni						
• Shtimi i fluksit të vizitorëve, • Rritja e arkëtimeve, • Terheqja e vëmendjesturistike. • Vizitorët marrin shërbimin për të cilin kanë paguar						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshmenëprojekt		
- Muzeu Historik Shkodër				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurim e	Ope rativ e	Trans ferim e	kapit ale
Shtypje biletash (20 000 cope)	150			150		
Përmasa 18.5 cm x 6.5 cm. letër 80 gr. me grafikë ngjyrë blu në sfond të bardhë, ku në të shënohen logot e muzeut “Oso Kuka” për njërin model dhe logoja e “Muzeut të Kështjellës” per modelin tjetër dhe Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës. Biletat duhet të jenë të grupuara në blloqe me nga 50 fije me çmimin dhe numrin serial përkatës (sipas modelit që ofrojme ne). Për më qartë si më poshtë përshkrimi; Nga këto 15.000 bileta për të rritur të cilat ndahen: 3000 copë të ndara në blloqe nga 50 fije me logon e Muzeut “Oso Kuka” me numër serial nga D00001 –D 03000 10.000 copë bileta të ndara në blloqe nga 50 fije dhe me logon e Muzeut të Kështjellës me numër serial D00001 – D 10.000 (Për të rritur): 2.000 copë të ndara në blloqe nga 50 fije me logon e “Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës ” me numër serial nga D00001 –D 02000(Për të rritur):						

Po ashtu 5.000 bileta për të vegjël të ndara sipas kësaj kërkesë: 500 copë bileta të ndara në blloqe me nga 50 fije me këtë numër serial : D 00001 –D 00500 me logon e Muzeut “Oso Kuka ”, për të vegjël dhe : 4.000 copë bileta të ndara në blloqe me nga 50 fije me këtë numër serial ; D 00001 – D 04000 me logon e Muzeut të Kështjellës për të vegjël 500 copë bileta të ndara në blloqe me nga 50 fije me këtë numër serial : D 00001 –D 00500 me logon e “Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës”, për të vegjël						
Shuma	150			150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Shtypjetash (20 000 cope)	150			150		
Shuma	150			150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Shtypjetash (20 000 cope)	150			150		
Shuma	150			150		
f) Periudha e zbatimit Prill-Maj 2017		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Muzeut Historik				

Nr.3	P11.F1.O1.A3 Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve arkeologjike	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet rekreative Funksioni: P11.F1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
	18 prilli, është Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve, e shpallur si e tillë nga ICOMOS dhe UNESCO. Që prej vitit 1982 në të gjitha vendet e botës, në këtë datë vihen në pah vlerat e trashëgimisë kulturore. Mbrojtja dhe ruajtja e tyre kërkon përpjekje të përbashkëta dhe koherente nga të gjithë segmentet e shoqërisë. Muzeu i Shkodrës në bashkëpunim me Parkun Arkeologjik Shkodër, në Kalanë Rozafa para disa kohësh kanë evidentuar prezencën e një objekti arkeologjik të periudhës së antikitetit me shumë vlera për historinë e Shkodrës dhe me gjerë. Arritshmëria nga ana e publikut për tek objekti është shumë e vështirë pasi ndodhet në thellësi të ndërtimeve mesjetare. Nisur nga ky fakt lindi ideja që objekti të vijë tek publikui ekspozuar në formë të riprodhuar në 3D. Nisur nga kjo janë konceptuar detaje teknike dhe shkencore që në përkujtim të Ditës së Monumenteve dhe Siteve Arkeologjike, Muzeu Historik, në bashkëpunim me Parkun Arkeologjik, Shkodër do ta bëjnë të ekspozueshëm kopjen e këtij objekti të rrallë. Mbi objektin arkeologjik në steren nr.2 të Kalasë së Shkodrës Në vitin 2007 gjatë një projekti për pastrimin dhe dokumentimin e plotë të sterve të ujit në Kalanë e Shkodrës u ra në gjurmë të një objekti arkeologjik. Bëhet fjalë për një kolonë mbajtëse të qemerit të sterës, të ndërtuar duke ripërdorur blloqe antike prej guri. Rezultoi, se njëri prej tyre ishte baza gëlqerore në formë paralelepipedit e një monumenti. Në faqen e përparme të të cilit brenda profilimit ishte ruajtur thuajse në tërësi një mbishkrim honorifik latin. Në faqet anësore i njëjti bllok kishte shkrime të shkurtra me të njëjtën përmbajtje honorifike në gjuhën greke dhe latine. Në vitin 2011 kjo sterë uji duke shfaqur një interes arkeologjik u bë pjesë e projektit studimor arkeologjik të Misionit Shqiptaro-polak që gërmon dhe studion këtë territor dhe Kalanë e Shkodrës specifikisht nga viti 2011. Misioni u mor gjerësisht me këtë mbishkrim i cili paraqet shumë vlera arkeologjike pasi rezulton të jetë i pari i zbuluar në Shkodër që i përket periudhës antike e kryesisht asaj romake. Fragmente mbishkrimesh romake janë evidentuar dhe dokumentuar edhe më herët në shek. XIX-XX nga L. Hann apo T. Ippen që i përkisnin periudhës së Sempitium Severus. Fatkeqësisht sot nuk dihet vendodhja e tyre për shkak të nivelit të ujrave dhe rrjedhës së lumit Drin. Kjo e bën edhe më të rëndësishëm dhe zbulimin, studimin, evidentimin, ekspozimin dhe promovimin e mbishkrimit të zbuluar në steren nr.2 të Kalasë, mbishkrim që i përket periudhës kur Shkodra kishte marrë tashmë statusin e kolonisë romake dhe datimin e tij mund ta përcaktojmë si i shek. I pas Krishtit. Ia vlen të përmendet, se ky është një dedikim me emrin zyrtar të qytetit colonia Scodranorum, status i cili vërtetohet gjithashtu në njëmbishkrim të zbuluar në Doklea (Mal të Zi) që daton nga fundi i shek. I-rë pas Krishtit. Shkrimi në faqen e përparme të bazës mund ta lexojmë në mënyrën e mëposhtme: C · C · F · MEMMIO IVLIO MAIORIARIO CALI GA PRIMA OPTIONI · PRIMIPILARIORVM SVBCOMMENTARENSI · COMMENT[.]JENSI COR NICVLARIO PREFF · PRAETORIO PRIMIPILARI · LARI · VE · DVCENARIO PATRONO · ORDO SPLENDIDISSIMVS · COLONIAE · SCODRANORVM · FELI Përkthimi: "Caius Memmius Iulius Maioriarusit, birin e Caiusit, që kreu shërbimin ushtarak, duke patur funksionet e: optio primipilariorum, subcommentariensis, commentariensis, cornicularius praefectorum praetorio, primipilaris, me titullin vir egregius, ducentarius, patronit, këshilli i madhërisë qytetë - koloni të Shkodranëve [i vendosi këtë monument]. Le të jetë i lumtur." Bie në sy një nga funksionet ushtarake cornicularius që shfaqet në mjedisin e mëkëmbësve të ndryshëm të provincave, të komandantëve, oficerëve të lartë të legjioneve romake dhe njësisë të tjera, si dhe në raport me njësi të tëra ushtarake në territoret e kolonizuara ndërkohë. Rëndësia e ekspozimit të kopjes së këtij objekti qëndron në faktin se aty flitet jo vetëm për nderim perkushtim ndaj një legjionari të lartë "Cornicularius", titull i përhapur shumë në periudhën e Hadrianit. Ky ushtarak mund të ketë drejtuar legjione në Afrikë ose Azi sepse është këshilli i qytetit koloni që ia dedikon. Vlera e madhe është se citohet Këshilli koloni i Shkodrës dhe meqë kishte këshill, qyteti kishte marrë statusin Municipium.	
	ii. Synimi i projektit - Thellimi i mëtejshëm në të vërtetat e historisë dhe rëndësisë së rajonit të Shkodrës gjatë periudhës Antike si një qendër me peshë në historinë rajonale e më gjerë. - Pasurimi i lëndës arkeologjike me një objekt që rrit peshën specifike të Shkodrës në historinë e Europës e me gjerë, - Rritja e atraksionit turistik në vëmendjen e të interesuarve për këtë lloj turizmi. - Përkthimi nga latinishtja në shqip i tekstit të objektit.	

iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
- Bashkërendimi i punës mes institucioneve të tilla si Muzeu Historik, Bashkia Shkodër, DRKK-Shkodër dhe Ministrisë së Kulturës - Mundësimi i një grupi ekspertësh që studion faktin - Hartimi i specifikimeve teknike në bashkëpunim me specialistë të fushës - Përgatitje materiali promovues - Ekspozimi dhe promovimi i këtij objekti në format 3D për publikun gjerë si një event kulturor.						
b) Rezultatet që prisni						
- Njohja me faktet e reja historike për qytetin e Shkodrës, - Tërheqjet e vëmendjes ndaj grupeve shkencore arkeologjike dhe historike të fushës dhe periudhës, - Atraksion turistik vendas dhe të huaj, - Promovim i trashëgimisë kulturore.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
- Muzeu Historik - Muzeu i Kështjellës, - Parku Arkeologjik - DRKK-Shkodër, - Bashkia Shkodër, - Ministria e Kulturës, - Studiet, - Vizitorët						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	kapitale
Honorare Skulptor	60			60		
Honorare Ndihmes Skulptor	10			10		
Materiale për vëllimin skulptural	20.3			20.3		
Transport	9.7			9.7		
Shuma	100			100		
f) Periudha e zbatimit Gjatë vitit 2017		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Muzeut Historik				

Materiale për vëllimin skulptural: 20 300

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefte
1	Rezine	litra	17	441.17	7500
2	Katalizator	litra	2	600	1200
3	Thes pluhur mermer	kg	40	25	1000
4	Allci	kg	50	68	3400
5	Balte qeramike	kg	40	50	2000
6	Dyll për izolim rezine	kg	2.5	400	1000
7	Lesh xhami për forcim	Gram	500	2.4	1200
8	Armature druri	ML	4	750	3000

Permasat e Gurit 3D :110 cm x 90 cm



Nr. 4	P11.F1.O1.A4 Mbështetje për funksionimin e aktivitetit dhe shërbimin në vazhdim të Muzeut Historik Shkodër	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet rekreative Funksioni: P11.F1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
i. Situata		
Muzeu Historik i Shkodrës ka nisur të organizohet që në vitin 1947, nën emërtimin "Muzeu Popullor" dhe mori formë të plotë në vitin 1949. Ai u vendos në qendër të qytetit, në një ndërtesë monumentale të shekullit të XIX-të, vlerat e së cilës ia shtonte "Kulla e Sahatit" pranë tij. Muzeu fillimisht u ngrit mbi bazën e koleksioneve të vjetra të kuvendeve të Jezuitëve dhe Frances kanë vethemeluar që nga fundi i shekullit të XIX, si dhe nga koleksionet e familjeve shkodrane. Më pas ato erdhën duke u shtuar përmes dhurimeve, blerjeve, gjetjeve të rastit dhe gërmimeve arkeologjike. Gjatë viteve në vazhdim ngrihen edhe muze të shtëpi-muze të tjera, duke formuar një rrjet muzeal prej 7 qendrash muzeale në qytetin e Shkodrës. Me reformat e thella që u ndërmorrën në fillim të viteve 1990, sidomos me kthimin e pronave të ish-pronarëve, shtëpitë ku ishin ngritur muzeut u privatizuan e rrjeti muzeal u shpërbë, duke mbetur në funksion vetëm Muzeu qendror ku u grumbulluan të gjitha objektet muzeale të qendrave të mëparshme. Në vitin 1996, Muzeu Historik i Shkodrës u transferua në banesën monumentale të restauruar (shtëpi karakteristike shkodrane që mban emrin "Oso Kuka") ku ndodhet edhe sot. Paralelisht me të vazhdon të funksionojë edhe Muzeu i Kalasë "Rozafa" i vendosur në godinën e Kapitenerisë, i cili është hapur në vitin 1987. Këto dy vitet e fundit strukturës organike të Muzeut i është shtuar edhe ajo e Vendlës së Dëshmisë dhe Kujtesës ku në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe specialistët e këtij sektori bëhen përpjekje për evidentimin dhe plotësimin e panoramës historike lokale kombëtare, veçanërisht për periudhën e diktaturës dhe pasojave të saj. Muzeu Historik i Shkodrës është një muze lokal dhe bën pjesë në rrjetin e institucioneve kulturore në varësi të Bashkisë Shkodër. Ai përbëhet nga Muzeu qendror (i vendosur në shtëpinë e Oso Kukës) dhe ai i Kalasë "Rozafa". Muzeu përbëhet nga seksionet e mëposhtme: në atë të arkivit, etnografisë, arkeologjisë, të artit pamor dhe bibliotekës. Kjo e fundit shërben si fond i studimeve shkencore që kryen stafi punonjës në veprimtarinë e tij. Muzeu organizon periodikisht aktivitete komemorative, konferenca e seminare me tematika të ndryshme. Brenda qytetit ai bashkëpunon me sukses me Universitetin "Luigj Gurakuqi", Bibliotekën "Marin Barleti", Galerinë e Arteve dhe Teatrin "Migjeni", dhe me institucione të tjera simotra në Shqipëri e në rajon. Përmirësimi i dukshmërisë së sallave të Muzeut të Kalasë. Lyerje me gëlqere dhe vaj lini i ambjenteve të brendshme. Vitin që shkoi në Muzeun e Kështjellës, është kryer procesi i lyerjes me gëlqerimureve të brendshme të Muzeut të Kështjellës. Problemi më i madh që ka Muzeu i Kështjellës është prezenca e lartë e lagështirës e cilabënqëatytë krijohet mykimi i madh. Lagështira futet nga ana e jashtme e mureve nëpër fugat e vjetra duke filluar që nga periudha e shirave deri në korrik. Prezenca e mykut, insektet që jetojnë në këto habitate janë prezente dhe shqetësuese për vizitorin, duke krijuar një pamje aspak të pëlqyeshme. Për të ruajtur imazhin dhe vlerat e trashëgimisë kulturore që ndodhen në këtë muze, është e nevojshme mirëmbajtja permanente e ambjenteve dhe objekteve të ndodhura aty. Lyerja e materialeve të drunjtave me vaj lini dhe lyerja e hapësirave murale me gëlqere është një domosdoshmëri e përvitshme. Vaji i linit është forma tradicionale, në ato vende ku krijohet lagështirë, vaji i linit është lënda e parë e konservimit të drurit në kontakt me agjentët atmosferikë. Gëlqerja është forma tradicionale që është përdorur në atë godinë për muret e brendshme që nën ndikimin e lagështirës së përhershme, e kërkon këtë shërbim. Kjo formë kurimi do të mbetet e tillë deri në momentin kur godina ku është vendosur Muzeu i Kështjellës që i takon shek. XIII-XIV, të mund të riparohet totalisht. Projektat karakteristë të vazhdueshëm. Blerje kamera sigurie dhe shërbim për kamerat ekzistuese të Muzeut të Kështjellës dhe të Banësës "Oso Kuka" Me kalimin e kohës gjendja teknike e sistemit të kamerave vëzhguese dhe sistemit të alarmit, kërkon që të përmirësohet funksionaliteti optimal i tyre. Disa prej kamerave të jashtme dhe të brendshme shfaqin probleme në funksionim, njësitë qendrore të tyre nuk përgjigjen sipas kushtit teknik. Sistemet e alarmit ndikohen nga kushtet atmosferike. Janë parashikuar shërbime teknike dhe blerje të pajisjeve të reja të sistemit të sigurisë në funksion të përmirësimit të kushteve teknike dhe ligjore të funksionimit të muzeve. Blerje 3 hard disqe për dixhitalizim të fondit të Muzeut Historik, Shkodër Puna kërkimore shkencore, konservimi dhe ruajtja janë tre elementët bazë të punës në muzeologji. Gjendja e kompjuterave të punës për njërin sektor është i dobët. Cilësia aktuale e tyre lë për të dëshiruar në mënyrën si punojnë. Duke qenë se këto kompjutera punë kanë informacion me vlerë të grumbulluar me kalimin e kohës, është e domosdoshme blerja e tre hardisqeve të jashtëme, ku do të ruhet i gjithë materiali i dixhitalizuar. Kjo vjen si pasojë e punës kërkimore që është kryer me kalimin e kohës. Dixhitalizimi është një kërkesë e kohës, po aq një nevojë imediate siç operon aktualisht muzeu pa një database bashkëkohor sipas standarteve muzeale të kohës. Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik, Shkodër Me anë të këtij shërbimi kryhet fotografimi dhe stampimi cilësor sipas rregullit të përcaktuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit i objekteve. Ky proces ndikon në standartizimin e dokumentimit dhe kartelizimit të fondeve muzeale. Ai lidhet tërësisht me punën bazë të ruajtjes së trashëgimisë kulturore materiale dhe plotësimit të informacionit për kartelat e objekteve. Mungesa e një mjeti të tillë vonon proceset bazë të punës kërkimore shkencore të stafit.		
ii. Synimi i projekteve		
- Lyerja me gëlqere dhe vaj lini ndikon në evitimin e situatave të papëlqyeshme në prezantimin me publikun. - Ruajtja e shëndetit të objekteve dhe punonjësve, - Rritje e parametrave të kushteve të vizitueshmërisë,		

- Më shumë pastërti
- Projekti për përmirësimin e sistemit të sigurisë synon rritjen e parametrevë të sigurisë,
 - Ruajtja sipas ligjit e objekteve të trashëgimisë kulturore.
 - Projekti për blerjen e 3 hardisqeve të jashtëm, synon konservimin dixhital të fondeve dokumentare,
 - Përmirësimin e performancës së punës,
 - Ruajtjen dhe konservimin e materialeve me vlerë studimore dhe shkencore, që përbëjnë punën bazë të muzeut.
 - Projekti i kartelimit synon zbatimin e rregullores ligjore të vendosur nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit dhe të ligjit për funksionimin e muzeve.
 - Forcimin e vlerave të identitetit kombëtar në nivel shkencor lokal e mëtej.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Për pikën 1

- Vlerësimi i nevojave për ndërhyrje në ambientet e Muzeut të Kështjellës
- Hartimi i konceptit teknik i sipërfaqes me metrat e kërkuar dhe sasinë e materialit që korrespondon shërbimit.
- Pastrimi dhe hapja e sërish për publikun.

Për pikën 2

- Hartimi i specifikimeve teknike të materialeve dhe shërbimeve që korrespondin me tërësitë e sigurisë.

Për pikën 3

- Prokurimin e tre hardisqeve të jashtëm 1 tera byte.
- Fillimi i punës për dixhitalizimin e materialeve.

Për pikën 4

- Përpilimi i specifikimeve teknike për parametrat e fotografive masa dhe cilësi imazhi sa më të lartë

b) Rezultatet që prisni

Pika 1

- Paraqitje dinjitoze e faqeve të brendshme të godinës së Muzeut të Kështjellës dhe zgjatja e jetës së materialeve të druritë që ndodhen nën ndikimin e agjentëve atmosferik.

Pika 2

- Kontroll më i mirë i kushteve të sigurisë së objekteve muzeale brenda dhe jashtë tij.

Pika 3

- Ruajtja dhe aksesibilitësisht i arritshëm në përdorimin sipas nevojave të dokumentave të dixhitalizuar.
- Ruajtja nga rreziku i dëmtimit.

Pika 4

- Përmirësim të gjendjes dokumentuese të fondeve muzeale, duke zbatuar ligjin e funksionimit të muzeve.

c) Aktorët e mundshëm

Muzeu i Kështjellës
Muzeu "Oso Kuka"

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operative	Transf erime	kapi tale
A.1	Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës. Mirmbajtje rre me gelqeredhevajlini	150			150		
A.2	Blerje kamera sigurie Muzeu i Kalase dhe Oso Kuka (3 kamera ,1 monitor dhe 1 DVR 8)	60					60
A.3	Sherbim per kamerat ekzistues Muzeu i Kalase dhe Oso Kuka	10			10		
A.4	Blerje 3 hard disqe per dixhitalizim te fondit Muzeu Oso Kuka (1 TB secili)	40					40
A.5	Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik Oso Kuka (Fondi i Arkivit)	150			150		
	Shuma	410			310		100
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operative	Transf erime	kapi tale
A.1	Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës. Mirmbajtje rre me gelqeredhevajlini	150			150		
A.2	Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik Oso Kuka (Etnografia)	150			150		

	Shuma	300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Pa ga	Siguri me	Operati ve	Transferi me	kapi tale
A .1	Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës. Mirmbajtje, lyrje me gelqeredhevajlini	150			150		
A .2	Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik Oso Kuka (Arkeologjia)	150			150		
	Shuma	300			300		
f) Periudha e zbatimit Prill-Maj 2017		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Fatmir Juka Ndricim Mlika					

Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës 150

Nr	An	Lloji i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.310	Riparime mure te brendshme h-4m me krah, llaci perzier M25	m2	32	801.9	25 660
2	2.399	Lyerje muresh me gelqere	m2	859	60	51 540
3	2.400	Lyerje dyshemeje druri me vaj lini	m2	280	260	72 800

Kartelizimi i fondeve të objekteve të Muzeut Historik"Oso Kuka": 150

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Fotografim , te objekteve te fondeve te Muzeut Oso Kuka (Fondi i Arkivit) 1000 Objekte	Cope	1 000	50	50 000
2	Perpunim grafik	Cope	1000	50	50 000
3	Stampimi	Cope	1000	50	50 000

Nr.5	P11.F1.O1.A5 Ribotim i guidës së Muzeve të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit: P11. Kultura dhe shërbimet reakreacionale Funksioni: P11.F1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.				
Në themel të punës së vet, muzeu ka edhe promovimin e vlerave që ruan me karakter lokal dhe përtej. Në vitin 2010, për herë të parë Muzeu Historik botoi guidën e vet prezantuese të një cilësie grafike dhe informuese të një niveli tërësisht profesional duke u kthyer në një element promovimi të denjë në prezantimin e kulturës së rajonit tonë. Hapësira informuese me shkrim dhe fotografi që ka modeli i guidës, shtrihet gjerësisht që nga koha e neolitit deri në shekullin XX-të. Informacioni është gjithëpërfshirës dhe prezantimi i parë me publikun ka qenë tepër dashamirës. Situata Muzeale në Shkodër dhe më gjerë ka ndryshuar dhe pritet të ndryshojë me kalimin e kohës. Vitet e fundit rrjetit muzeal në Shkodër i janë shtuar rikonstruksioni i muzeut të Kështjellës, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës. Për këto arsye është parashikuar ribotim i guidës së Muzeve të Bashkisë Shkodër me çdo risi që është shtuar në vite. Kjo përbën një nevojë për njohjen dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të vëmendjes së publikut vendas dhe të huaj, me materiale që ngjallin interesin e tyre kundrejt hapësirës së Bashkisë Shkodër. Pajisja me materiale të tilla promovuese është një kërkesë permanente e publikut vendas dhe të huaj.Në pamundësi për të marrë me vete "historinë fizike", vizitorët kërkojnë një interpretim të saj në formë guide ose libri udheheqës për vlerat që ruan muzeu. Aktivitetet që zhvillon muzeu, faqja web, mbulimi mediatik dhe materialet promocionale rrisin prezencën e tij në sytë e publikut duke synuar afrimin e tij të mëtejshëm me to.						
ii. Synimi i projektit						
